


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT



OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/ GILAN BELEDIYESI

KONTRATË PËR PUNË

E lidhur më: 23.01.2018

KUVENDI KOMUNAL- GJILAN, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe
" CDC " SH.P.K nga **Gjilani**, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Renovimi i sallës së shtëpisë së Kulturës në fshatin Zhegër

me numër identifikues: **651-17-5206-5-2-1**

Numëri prokurimit: **GI 651 17 073 521**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

Renovimi i sallës së shtëpisë së Kulturës në fshatin Zhegër

Kontraktuesi do të filloj me punë menjëherë pas marrjes së urdhrorit nga Autoriteti Kontraktues për fillimin e punëve.

1.2 Kohëzgjatja e projektit

Plani dinamik për kryerjen e punëve: 90 ditë pune.

1.3 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë: **Shtëpia e kulturës në fshatin Zhegër.**

1.4 **Zyrtari Kryesor Administrativ "ZKA"** - me shkrim do ta emërojë Menaxherin e Projektit përgjegjës për menaxhimin (mbikqyrjen) e kontratës specifike dhe për ta informuar Zyrtarin përgjegjës të Prokurimit.

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **40,473.18 €**;

Çmimi i punëve me fjalë: **Dyzet mijë e katërqindë e shtatëdhjetë e tre Euro. Tetëmbëdhjetë cent.**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria); 14.12.2017
- (f) (Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)
- (g) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën [shqipe] në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Salih Kqiku
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	23.01.2018
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	Ardian Llapashtica
Pozita:	Drejtore
Nënshkrimi:	
Data:	23.01.2018
Vula:	



Nr.prokurimit: **GI 651 17 073 521**; Titulli: **Renovimi i sallës së shtëpisë së Kulturës në fshatin Zhegër**

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Punëkryesi , jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, do të dorëzoj tek KK Gjilan një sigurim për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% I vlerës se kontratës për kohëzgjatjen prej 120 ditëve.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 15 ditë nga data e pranimit të kërkesës së menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë: jo më vonë se 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 90 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është

		10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri : punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahet në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit .
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është Isa Veliu
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <i>Nuk ka pagesa paraprake</i>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë, jo më vonë se 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 1 vit pas kryerjes së punëve dhe pranimit teknik.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni Rregullativ Publik-Divizioni i Rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës Themelore-Gjilan në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>Ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrashit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregëtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyren e zgjedhjes së mosmarrëveshjes, Gjykata apo Arbitrimi.</p>